



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 12  
02.07.2012

NR. VENDIMI 6  
04.07.2012

**VENDIM**

**“PËR SEKUESTRIMIN E KORRESPONDENCËS”**

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda, Tirane, e perbere prej:

**Ardit Mustafaj - GJYQTAR**

Asistuar prej sekretares Olta Sinanaj, sot me dt.04.07.2012, mori ne shqyrtim, ne seance gjyqesore me dyer te mbyllura, kerkesen e paraqitur prej:

**KËRKUES:** Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda, Tirane, e perfaqesuar nga prokurori Behar Dibra.

**OBJEKTI:** Vendosjen e sekuestros se korrespondences postare (mbi tre zarfa).

**BAZA LIGJORE:** Neni 209 i K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet dhe degjoi prokurorin B. D. , i cili kerkoi pranimin e kerkeses,

**V Ë R E N se:**

Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, me dt.29.06.2012, ka rregjistruar procedimin penal nr.95, per vepren penale te “Veprave me qellime terroriste” te parashikuar nga neni 230 i K.Penal.

Rregjistrimi i ketij procedimi eshte bere mbi bazen e informacionit te marre nga policia gjyqesore per mberritjen e tre zarfave ne Filialin e Postes Tirane, ne dy prej te cilave si adrese marresi eshte shenuar “Al Queda and Taliban News media House 267 street Postbox 2892 Tirana Albania”, ndersa ne

zarfin e trete eshte shenuar “Bin Laden Helfer in Albanien Postbox 2892 Tirana Albania”. Te tre keto zarfa kane pulla postare me shkrimin “Deutschland”, nga nje etikete sherbimi me shkrimin “PRIORITY PRIORITAIRE/LUFTPOST”, si dhe vula te Postes Shqiptare. Ne keto zarfa nuk eshte shenuar adresa e derguesit.

Nga ana e prokurorise, bazuar ne nenin 209 te K.Pr.Penale, kerkohet nga gjykata qe te vendoset sekuestrimi i ketyre zarfave, me qellim qe pas kesaj ato te hapen dhe te njihet permbajtja e tyre, ne funksion te hetimeve per vepren penale te mesiperme.

Gjykata çmon se kerkesa e prokurorise eshte e drejte dhe duhet pranuar.

Neni 209, pikat 1 dhe 2 te K.Pr.Penale, parashikon:

*“1. Kur gjykata ka arsye te bazuara te mendoje se ne zyrat postare ose telegrafike gjenden letra, letra me vlere, zarfa, pako, telegrame dhe objekte te tjera te korrespondences qe jane derguar nga i pandehuri ose qe i drejtohen atij, qofte edhe me emer tjeter ose nepermjet nje personi tjeter, vendos sekuestrimin e tyre.*

*2. Kur sekuestrimin e kryen nje oficer i policise gjyqesore, ai duhet t'i dorezoje organit gjyqesor objektet e sekuestruara te korrespondences pa i hapur dhe pa u njohur me ndonje menyre tjeter me permbajtjen e tyre”.*

Nga aktet qe ka paraqitur prokuroria, rezulton se me procesverbalin dt.29.06.2012, ora 15.00, policia gjyqesore, ne kushtet e veprimeve me inisiative te saj, ka bere kqyrjen dhe marrjen e tre zarfave te mesiperme.

Po me dt.29.06.2012, policia gjyqesore, duke vepruar me inisiative sipas neneve 294 e vijues te K.Pr.Penale, ka bere edhe sekuestrimin e ketyre zarfave dhe ia ka dorezuar ato prokurorit te pahapura, por ky sekuestrim i bere me inisiative eshte vleftesuar i paligjshem nga prokurori, me vendimin e dt.30.06.2012, bazuar ne nenin 301 te K.Pr.Penale. Sipas ketij vendimi *“...veprimi i sekuestrimit te ketyre sendeve nga ana e oficereve te policise gjyqesore eshte i pabazuar ne ligjin procedural, pasi nuk jemi ne rastet e ngutshme te vendosjes se sekuestros nga ana e tyre”.*

Pas kesaj, me kerkesen objekt gjykimi, prokurori ka kerkuar qe sekuestrimi i korrespondences te kryhet me vendim te gjykates.

Ne keto kushte, gjykata cmon se vleftesimi i paligjshem nga prokurori i sekuestros se bere me inisiative nga policia gjyqesore i hap rrugen paraqitjes ne gjykate te kerkeses per vendosjen e sekuestros se kesaj korrespondence, ashtu sic parashikon neni 209/1 i K.Pr.Penale, e cila nuk mund te sekuestrohet me inisiative nga policia gjyqesore, por vetem me vendim te gjykates, sipas nenit 209/1 te K.Pr.Penale dhe me urdher te prokurorit ne raste te ngutshme, sipas nenit 299/2 te K.Pr.Penale.

Gjykata vlereson se, duke u nisur nga te dhenat qe pasqyrohen mbi tre zarfat e siperpermendur, ka arsye te besohet se ato mund te kene lidhje me vepren penale per te cilen eshte rregjistruar procedimi penal dhe me personat e mundshem te perfshire ne nje veprimtari te tille, konform neneve 208/1 dhe

209/1 te K.Pr.Penale. Per kete arsye, gjykata çmon se duhet vendosur sekuestrimi i tre zarfave te mesiperm, veprim i cili do t'i ngarkohet oficerëve te policise gjyqesore te treguar nga prokurori ne seance gjyqesore.

Per sa me siper, rezultoi nga aktet e shqyrtuara ne seance gjyqesore.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, ne baze te nenit 209, pikat 1 dhe 2 te K.Pr.Penale,

### **V E N D O S I :**

1. Pranimin e kerkeses se Prokurorise per Krime te Renda Tirane, duke vendosur sekuestrimin e tre zarfave te ardhur ne Posten Shqiptare, Filiali Tirane, ne te cilat si adrese marresi ne dy prej tyre eshte shenuar "Al Queda and Taliban News media House 267 street Postbox 2892 Tirana Albania", ndersa ne zarfin e trete "Bin Laden Helfer in Albanien Postbox 2892 Tirana Albania", me qellim njohjen me pas me permbajtjen e tyre nga ana e kesaj Prokurorie.

2. Sekuestrimi te kryhet nga oficeret e policise gjyqesore prane Prokurorise per Krime te Renda, Tirane, I. H. dhe B. D. , te cilet te dorezojne prane kesaj Prokurorise objektet e sekuestruara pa i hapur dhe pa u njohur me ndonje menyre tjeter me permbajtjen e tyre.

**Tirane, me 04.07.2012.**

**SEKRETARE**

**OLTA SINANAJ**

**GJYQTAR**

**ARDIT MUSTAJ**